



Mësoj rreth  
fëmijës

# Hyrja në kopësht (parashkollor)

Përshtatja me ambientin shkollor, ku kushtet dhe kërkesat janë të ndryshme nga ato të ambientit familjar, përbën një ndryshim të rëndësishëm si në jetën e fëmijës ashtu dhe të familjes, i cili është i domosdoshëm për shoqërimin e fëmijës.

Kur prindërit ndahen për herë të parë nga fëmijët e tyre mund të shqetësohen për mënyrën si ata do të reagojnë, pritjen e tij nga mësuesi /mësuesja që do ta marrë përsipër, por dhe nga fëmijët e tjerë.

Në fillim, shumica e fëmijëve, vështirësohen të ndahen nga prindërit e tyre, të integrohen në një program me rregulla të caktuara dhe në një grup me persona të panjohur. Ndërkohë kjo vështirësi nuk duhet t'i shqetësojë prindërit, sepse me lëvizje të përshtatshme mund të kapërcehen.

## Çfarë mund të bëjnë prindërit që të lehtësojnë përshtatjen e fëmijës?

- Bëjnë bashkë me fëmijën një vizitë paraprake në kopësht, para se të fillojë viti shkollor, në mënyrë që ai/ajo të familjarizohet me ambientin dhe të krijojë një marrëdhënie personale me mësuesin/ mësuesen.
- Bëjnë ata vetë një takim personal me mësuesin/ mësuesen duke folur për dëshirat dhe vështirësitë e mundshme të cilat mendojnë se do të përballojë fëmija i tyre (duke iu referuar karakterit të tij/saj). Këto informacione do të jenë të nevojshme për mësuesin /mësuesen që të njohë më mirë fëmijën, por dhe mendimet e prindërve.

- Nëse vështirësohen me gjuhën, ata mund të përdorin ndonjë të afërm apo shok/shoqe (dhe jo fëmijën) që t'i ndihmojë në komunikimin me mësuesin/ mësuesen.
- Shoqërojnë fëmijën ditën e parë të kopshtit dhe qëndrojnë me të sa të jetë e nevojshme deri sa ai/ajo të ndiejë siguri.
- Tregojnë mirëkuptim në reagimet e fëmijës ditët e para (p.sh. ankesa, vështirësi në përgatitje, etj.)
- Inkurajojnë fëmijën të njihet me fëmijë të tjerë të grupit të tij me të cilët mendojnë se do të familjarizohet më shpejt, (p.sh. me fëmijë që banojnë pranë tyre apo me fëmijë, prindërit e të cilëve i njohin).
- Përgatitin fëmijën e tyre për realitetin shkollor duke i folur me realizëm për të, pa e trembur. Nuk theksojnë detyrimet, por elementët pozitivë, p.sh. nuk i thonë se mësuesi /mësueja do të jetë i/e rreptë, por që nga ai/ajo do të mësojë gjëra të reja. Gjithashtu, theksojnë faktin se në shkollë do të bëjë shokë/ shoqe të rinj/ reja që të luajë me ta, etj.
- E qetësojnë për çdo shqetësim të mundshëm që mund të ketë (p.sh. i thonë se për çdo gjë që nevojitet mund ta kërkojë nga mësuesi/ mësuesja, i japin fjalën se do të vijnë ta marrin në orën e duhur, etj).
- I tregojnë se kanë besim tek ai/ajo (p.sh. i thonë «jam i/e sigurtë se do t'ia dalësh mbanë vetë dhe se do të kalosh shumë mirë»).

\* **Duhet të kemi në mendje se** çdo njeri i përjeton ndryshe vështirësitë, reagon ndryshe ndaj tyre dhe nevojitet kohë të ndryshme për t'iu përshtatur kushteve të reja. Kështu disa fëmijë paraqesin në mënyrë të vazhdueshme vështirësi të theksuara përshtatjeje dhe nevojiten një mbështetje më të madhe. Duhet të mundemi të njohim dhe të respektojmë vështirësitë e këtyre fëmijëve.

## Mendojmë se një fëmijë vështirësohet kur për një kohë të gjatë:

- Nuk do që të ndahet nga prindi që e shoqëron në kopësht dhe duket i trishtuar gjatë gjithë kohës së qëndrimit të tij në të.
- Reagon në mënyrë të theksuar kur bëhet fjalë që të shkojë në kopësht, me të qara, pakënaqësira, kundërshton apo ankohet për dhimbje të ndryshme (p.sh. barku, koke).
- Paraqet çrregullime në gjumë ose në të ushqyer të cilat nuk i kishte para se të shkonte në kopësht.
- Ankohet se nuk ia del mbanë ose paraqet probleme në urinim apo /dhe në të dalët jashtë.
- Ka ndryshim të theksuar në sjelljen e tij (p.sh. agresivitet, mbyllet në vetvete).
- Ankohet për qëndrimin e fëmijëve të tjerë apo të mësuesit/ mësueses dhe shmanget t'u afrohet gjatë gjithë kohës së qëndrimit të tij në kopësht.
- Nuk ka dëshirë të flasë për çdo gjë që ndodh atje.

## Çfarë mund të bëjnë prindërit që të ndihmojnë fëmijën që vështirësohet?

- Të mos alarmohen në mënyrë të ekzagjruar. Zakonisht këto vështirësi janë të përkohëshme dhe edukatori/ edukatorja do t'i ndihmojë fëmijët me qëllim që t'i kapërcejnë sëbashku.
- Bisedojnë me edukatorin/edukatoren që të gjejnë një mënyrë përshtatjeje graduale të fëmijës. Nuk ngurrojnë të ndajnë me të shqetësimet dhe problemet e tyre. Roli i mësuesit/mësueses është të ndihmojë fëmijët, por edhe prindërit dhe jo t'i gjykojë ata.
- Dëgjojnë me vëmendje atë çka shqetëson fëmijën dhe përpiqen të gjejnë zgjidhje (p.sh. «mund të mos jem me ty, por çfarëdo që ti ke nevojë, mund ta kërkosh nga mësuesja/mësuesi ose mund t'i kërkosh të më marrësh në telefon nëse është ndonjë nevojë e madhe»).
- Ndajnë sëbashku ndjenjat e fëmijës, por dhe i tregojnë qartë caqet (p.sh. i thonë «e kuptoj që të vjen keq, por mua më duhet të iki. Nuk lejohet të qëndrojnë prindërit në shkollë»).
- Nuk nënvlerësojnë vështirësitë e fëmijës dhe nuk i komentojnë ato negativisht (p.sh. nuk thonë «nuk ke turp që qan, je i/e madh/e tani, nuk duhet të mërztitesh!»).
- Nuk e krahasojnë me fëmijët e tjerë (p.sh. nuk i thonë «pa shiko fëmijët e tjerë sa të gëzuar janë apo sa mirë rrinë!»).

- I japin kurajo dhe i thonë se do ta ndihmojnë për çdo gjë që ka nevojë (p.sh. «mos u mërztit, nëse diçka të shqetëson do ta shohim sëbashku se çfarë mund të bëjmë»).
- Inkurajojnë krijimin e marrëdhënieve me fëmijët e tjerë. Nëse është e lehtë, nxitin marrëdhëniet jashtë shkollore, p.sh. ftojnë ndonjë fëmijë në shtëpi ose organizojnë një takim në një park lojrash.
- I deklarojnë qartë se disa gjëra janë të pandryshueshme paçka se mund të jenë jo të kënaqshme (p.sh. i thonë se nuk bëhet të mos shkojë në shkollë).
- I propozojnë sende që mund të marrë me vete nga shtëpia që të ndiejë siguri (p.sh. një arush, një kukull, një makinë të vogël).
- I sygjerojnë fëmijës dhe edukatores/edukatorit tema bisede apo përralla që i pëlqejnë për të diskutuar në klasë (p.sh. kafshë të egra, makina).
- Theksojnë gjëra të mira që mund të bëjë (p.sh. «pas shkollës do të shkojmë të luajmë»).
- I flasin për përvojat e vështira të tyre dhe për mënyrat që i përballojnë (p.sh. «edhe unë mërztitesha para se të vinim të banojmë këtu, por pastaj njoha shokë/shoqe dhe isha i/e kënaqur»).
- I lexojnë libra me problematikë të njëjtë me atë të tijen (p.sh. «Dita e parë në shkollë», «Ah, ajo dita e parë e shkollës!», «Paki, ditën e parë të shkollës» etj.)
- I flasin pozitivisht, por dhe realisht për mësuesin/mësuesen dhe fëmijët e tjerë. I thonë p.sh. «jam i/e sigurtë se mësuesi/ mësuesja të do fort, por ndoshta nuk e kuptoi mirë çfarë kërkoi» apo «në lojë e sipër ndoshta dikush të shtyu pa dashur, por kjo s'do të thotë se donte të të godiste, as se nuk të ka xhan...!».

## Prindërit, pasi të kenë biseduar me mësuesin/mësuesen, do të ishte mirë të këshillohen me ndonjë specialist (p.sh. psikolog) kur:

- Vështirësitë e fëmijës janë të theksuara dhe të vazhdueshme dhe nuk dinë si t'i përballojnë.
- Fëmija vështirësohet të reagojë ndaj "ngacmimeve" që i jepen.
- Fëmija paraqet shqetësime fizike (vjell, ka dhimbje, etj.).
- Fëmija paraqet vështirësi në marrëdhëniet e tij me fëmijët e tjerë, p.sh. rri i vetmuar apo është shumë agresiv.



Enti zbatues

**POLIDHROMOS: Grupi dhe Botimi periodik për Dygjuhësinë dhe Shumëkulturrën në Arsim dhe në Shoqëri**



www.polydromo.gr  
polydromo@polydromo.gr

Autore teksti

**Anthula Kontopulu**, Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe të Arsimit Parashkollor, Universiteti Aristoteli Selanik

Koordinatorë të programit

**Birbili Maria – Cokalidhu Rula**

Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe të Arsimit Parashkollor, Universiteti Aristoteli Selanik

Email: mmpirmp@nured.auth.gr

tsokalid@nured.auth.gr

Website: www.polydromo.gr/dialogos

Përkthyes: **Valbona Hystuna / Përpunuan tekstin: Evi Marku**

Me mbështetjen e

